

FJALA E DEPUTETES ERALDA BANO

E HËNË 23 MAJ 2022

E nderuar Kryetare,

Të nderuar kolegë,

Të dashur qytetarë,

Sot po diskutojmë projektrezolutën për raportin e veprimtarisë së Medieve Audiovizive për vitin 2021.

Të dashur qytetarë, demokracia është funksionale kur të gjithë qytetarët e këtij vendi marrin vendime mbi bazën e informimit, për këtë arsye shpesh, në një kohë kur digjitalizimi është kthyer nga sensacion dhe komoditet në nevojë, me gjithë të mirat që ky i fundit sjell, ka edhe më shumë hapësira për ta përdorur si mjet për minimin e demokracisë. Ky fenomen, sigurisht, do të përdorej mjeshtërisht nga qeveria shqiptare, për ta shndërruar medien në një mjet propagande dhe kush me mirë se ish-zëdhënësja e Kryeministrit, zonja Armela Krasniqi, do të ishte e denjë për postin e drejtueses së Autoritetit të Medieve Audiovizive, AMA.

Të nderuar kolegë, pa arritur të problematika thelbësore që paraqet AMA, si institucion, lidhur me veprimtarinë e saj, që në nisje të emërimit të zonjës Krasniqi hasim me një shkelje të ligjit, përkatësisht të nenit 7, i cili rregullon zgjedhjen e kryetarit të AMA-s, duke cituar se kreu i AMA-s nuk duhet të ketë marrë pjesë në veprimtari politike. Përveç konfliktit të interesit, në rastin e zonjës Krasniqi kemi të bëjmë me një shkelje flagrante të ligjit. Një Kryeministër, i cili shkel ligjin, shkel edhe të drejtat e njeriut pa kurrfarë problemi, është dhunuesi kryesor i gazetarëve, duke ushtruar ndaj tyre forma të ndryshme të presionit psikologjik dhe të denigrimit të figurës së gazetarit apo medieve që i shkojnë kundër, duke u vendosur epitete nga më të shëmtuarat, ku më e famshmja është: “media kazan”.

AMA, si autoritet, hesht, edhe pse në misionin e saj, si institucion i pavarur, ka mbrojtjen e veprimtarisë së medieve në përputhje me legjislacionin në fuqi. Në projektrezolutë AMA ka dështuar dhe nuk është shprehur se duhet të intensifikohet puna, nëpërmjet rregullimeve ligjore, jo vetëm për garantimin e lirisë së medieve dhe të fjalës, por edhe për sa u përket gazetarëve. Si institucion i pavarur AMA nuk duhet të lejojë që presioni politik, influencat e tjera ekonomike apo ato të lidhura me shtetin të ndikojnë në punën që bëjnë mediet në emër të informimit të gjerë publik dhe demokracisë. AMA duhet të marrë

masa për parandalimin, denoncimin dhe mbrojtjen e gazetarëve, të cilët janë dhunuar në forma të ndryshme, qoftë verbale apo joverbale, në krye të detyrës.

Rastet e dhunës ndaj gazetarëve gra dhe vajza nuk kanë qenë në fokusin e AMA-s, pasi dhuna ndaj tyre jo vetëm thëllon pabarazinë, por tregon edhe fytyrën e vërtetë të kësaj qeverie. Pa dyshim, lidhur me sa përmenda më sipër, këto nuk do të ndodhnin nëse do të kishim një qeveri normale dhe një Kryeministër normal, i cili nuk kryen shkelje të tilla në emër të pushtetit të vet, duke vendosur në këtë rast zëdhënësen e tij në krye të AMA-s. Nga takimet me mediet lokale në qarkun e Fierit kam evidentuar, por edhe kam denoncuar më parë faktin se këto media po hasen me vështirësi financiare dhe me një rritje të konsiderueshme të taksimit.

Duke u gjendur përballë presioneve të tilla, si dhe pa mbështetje disa prej tyre janë drejt falimentit, ndërsa disa të tjera e kanë mbyllur aktivitetin, duke lënë papunë qindra qytetarë, ndërkohë që bizneset lokale e kanë totalisht të pamundur mundësinë e reklamimit. Në këtë rast AMA ka dështuar, sepse nuk e ka studiuar gjendjen e operatorëve lokalë dhe barrën financiare nga taksimi i tyre, po ashtu ka dështuar sepse nuk ka sjellë propozime konkrete për rimëkëmbjen e tyre dhe, aq më tepër krijimin e një tregu medietik më alternativ dhe më të lirë në të gjithë vendin.

Të nderuar kolegë, përkrahja ndaj qytetarëve mungon në çdo drejtim dhe këtë e shohin në çdo vepër të diktaturës moderne komuniste. Asnjë diferencë nuk bën shtypja dhe kontrolli ndaj medias sot nga Edi Rama me atë që ka ushtruar Enver Hoxha. Asnjë diferencë nuk bëni me paraardhësit tuaj. Fundja, dardha nën dardhë bie! Faleminderit!